[Shqiptarja.com]

E martë 31 Tetor 2023 - Përditësimi i fundit 13:51

Kërko

LIVE Shqiptarja.tv

HOME EDICIONET LOKALE KRONIKË POLITIKË SHËNDETI EKONOMI SPORT KOSOVË & RAJONI BOTË KULTURË EDITORIAL OPINION

TË FUNDIT SOCIALE DREJT PUNËS SPECIALE LIFESTYLE VIP & SPEKTAKËL RECETA HOROSKOPI DOSJE FOTOGALERI VIDEOGALERI PIKË E ZEZË SONDAZHE

Flash Deputetët e PS: Gazment Bardhi tentoi të godiste me shishen e ujit kryetaren e Kuvendit, Lindita Nikolla

POP 5 Artistët me të besuarin 'A I mbushim 'A' Fundit

1 Zi në botën e gastronisë sportive, ndahet nga jeta Bedri Alimehmeti

2 Nalbatani e goditi me grushti në Kuvend, Vulnet Sinaj: Faji i Sali Berishës! I kam falur, por do mbahtëse grupin PS nëse merr vendim

3 Mbakimi i sanocës dhe kazol dje në Kuvend, PS kërkon mesë diajtjeve për 7 deputetët, mbështetës të Sali Berishës (EMRAT)

4 Afera e 'Partizanit', Meta i del krah Berishës: Akuzuesi u dëbua nga Rama në kongresin e PS-së! Si solmon he bllok SPAK-un: 'S'janë si gjithë pak vatanxi

5 Nga rënderimi tek bujqësia sektorët që marrin më shumë fonde me rashkëmnie e buxhetit 2023! Meta: Rishqerndësjna 45.8 mil leke

Kronikë

'Tempulli'/ Shiste kanabis në afërsi të shkollave dhe vidhte dyqanet, arrestohet 18-vjeçari në Vlorë

Një 18-vjeçar është arrestuar në Vlorë në kuadër të megaoperacionit 'Tempulli'. Në pranga ka rënë Aleksandro Simoni, i cili shiste kanabis në afërsi të shkollave në qytetin e Vlorës.

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Gjeniusmu

Redaksia
31 Tetor, 12:03 | **Përditësimi: 31 Tetor, 13:14**

Share

A A

VLORË- Një 18-vjeçar është arrestuar në Vlorë në kuadër të megaoperacionit 'Tempulli'. Në pranga ka rënë Aleksandro Simoni, i cili shiste kanabis në afërsi të shkollave në qytetin e Vlorës. I riu, po ashtu kryente vjedhje edhe nëpër dyqane me pajisje elektronike.

Në banesën e tij u gjetën dhe sekuestruan 1 armë zjarri automatik, municion luftarak, 1 mjet prerës (thikë), si dhe dhjetëra pajisje elektronike (laptopë dhe celulare), të cilat dyshohet se i ka vjedhur më parë, në dyqane të ndryshme, në qytet.

[Sh.com]

LEXO EDHE:
'Tempulli'/ Shisnin drogë në Lezhë e Shëngjin, në pranga dy të rinjtë

Po ashtu, është vënë në hetim një 17-vjeçar, pasi gjatë kontrollit në banesën e tij, Policia gjeti sende të tjera të dyshuara të vjedhura nga 18-vjeçari i arrestuar, një sasi fishekësh luftarak si dhe një përforcues grushti.

Procedimi në gjendje të lirë nisi edhe për shtetasit K. D., 25 vjeç dhe R. B., 21 vjeç, pasi bashkë me 17-vjeçarin, kanë qenë në dijeni të veprimtarive kriminale të shtetasit A.S., por nuk kanë kallëzuar.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për veprime të mëtejshme.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 13:13

'Tempulli'/ Shisnin drogë në Lezhë e Shëngjin, në pranga dy të rinjtë

Dy të rinj kanë janë arrestuar në Lezhë, pasi shisnin drogë në zonën e Shëngjinit dhe në qytetin e Lezhës. Arrestimet janë bërë në kuadër të operacionit 'Tempulli'.

20-vjecarit Elvin Peraj gjatë kontrollit fizik, iu gjetën sasi lënde narkotike cannabis sativa, e ndarë në doza të gatshme për shitje, si dhe 2 grirëse të kësaj lënde. Ndërsa, 24-vjecarit, Eukild Doflanga, banues në Tiranë, pasi gjatë kontrolleve fizike dhe në automjetin ku ishte pasagjer, iu gjet dhe iu sekuestrua në cilësinë e provës materiale, një sasi lënde narkotike cannabis sativa, e ndarë në doza të gatshme për shitje.

> *"Qarku Lezhë/Vijon megaoperacioni policor i koduar "Tempulli". Goditen 2 raste të tjera të shitjes në doza, të lëndës narkotike cannabis sativa.*
>
> *Arrestohen në flagrancë 2 shtetasit që e kryenin këtë veprimtari kriminale në lagje të ndryshme, në Lezhë dhe në Shëngjin.*
>
> *Sekuestrohen një sasi lënde narkotike cannabis sativa, e ndarë në dhjetëra doza të gatshme për shitje, si dhe 2 grirëse të kësaj lënde.*
>
> *Si rezultat i veprimeve intensive operacionale të kryera në kuadër të megaoperacionit policor mbarëkombëtar, antidrogë, të koduar "Tempulli", Seksioni për Hetimin e Narkotikëve, në bashkëpunim me Forcën e Posaçme "Shqiponja", të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, me mbështetjen e informacioneve të sigurueara nga inteligjenca policore, kanë konstatuar dhe goditur 2 raste të tjera në këtë fushë, për të cilat u arrestuan në flagrancë shtetasit:*
>
> *•E. P., 20 vjeç, banues në Lezhë, pasi gjatë kontrollit fizik, iu gjetën dhe iu sekuestruan në cilësinë e provës materiale, një sasi lënde narkotike cannabis sativa, e ndarë në doza të gatshme për shitje, si dhe 2 grirëse të kësaj lënde;*
>
> *•E. D., 24 vjeç, banues në Tiranë, pasi gjatë kontrolleve fizike dhe në automjetin ku ishte pasagjer, iu gjet dhe iu sekuestrua në cilësinë e provës materiale, një sasi lënde narkotike cannabis sativa, e ndarë në doza të gatshme për shitje. Gjithashtu, për këtë rast u referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi në gjendje të lirë, për veprën penale "Mbajtja pa të drejtë e uniformës", për shtetasin M. V., 25 vjeç, banues në Tiranë, sepse në automjetin ku udhëtonte së bashku me të arrestuarin, në Shëngjin, iu gjet një tabelë si ato të Policisë Rrugore.*
>
> *Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për veprime të mëtejshme", njofton policia.*

SI.E./Shqiptarja.com

Share

SI.E./KT/Shqiptarja.com

TAG: Vlorë | Aleksandro Simoni | drogë afër shkollave | Megaoperacioni Tempulli

Komento

Ndalohet riprëdhënia i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:
Kaos e grushte në Kuvend, si e konsideroni skenarin e opozitës?

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera

Fusha e mbetjeve prej 10 ditësh në flakë, tymi mbulon qytetin e Vlorës! Banorët: Këtu nuk jetohet

Armand Xhelili

31 Tetor, 08:47

EMRI/ I mori flakë dysheku dhe u asfiksua nga tymi, vdes 65-vjeçari në Finiq! Jetonte i vetëm në banesë

30 Tetor, 15:32

Kanosi me armë gjahu një 57-vjeçar pas një konflikti me të, vihet në pranga 47-vjeçari në Vlorë

30 Tetor, 12:41

Operacioni 'Tempulli' në Berat dhe Tiranë, arrestohen 4 persona! Në mesin e tyre një 24-vjeçar, shiste kanabis pranë një shkolle në Kombinat

30 Tetor, 11:39

Stërvitja e NATO-s në Sazan, Forca Detare: Sot dhe nesër mjetet e kanë të ndaluar lundrimin në afërsi të ishullit

30 Tetor, 11:07

E rëndë në Sarandë, e moshuara bie nga ballkoni i katit të katërt të banesës! Humb jetën

29 Tetor, 18:25

Avdulaj u dorëhoq dy ditë më parë, Edmond Leka merr drejtimin e paraburgimit në Vlorë

Armand Xhelili

29 Tetor, 12:42

Aksion antidrogë gjatë natës në disa fshatra të Beratit, kontrolle në sera dhe bare

Mimoza Sinanaj

29 Tetor, 11:09



Operacioni 'Tempulli'/Goditen tre raste të shitjes së kanabisit në Lezhë, Mirditë dhe Berat! Arrestohen tre të rinj

29 Tetor, 10:18

Zvërneci plot edhe në fundetor, turistët e huaj vizitojnë Manastirin: Duhet të ketë ciceron, të informohemi

Armand Xhelili

28 Tetor, 16:05

Vlorë, 20 adoleshentë të varur nga heroina, trajtohen me metadon në qendrën 'Aksion plus'

Armand Xhelili

28 Tetor, 14:43

'Garancia Rinore' projekti pilot që synon punësimin e 18 mijë të rinjve në Tiranë, Shkodër dhe Vlorë

28 Tetor, 12:34

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje